

AUTORIZIM 2 - Shoqërimi Social -

Me këtë, unë,

Emri i plotë:

Data e lindjes:

Numri V:

dhe / ose

Numri i IND-së:

autorizoj punonjësit e Shoqatës për Ndihmë të Refugjatëve (VluchtelingenWerk) që:

- të dhënat personale të përgjithshme e të posaçme që kam dhënë unë dhe që janë të domosdoshme për qëllimet e përmendura më poshtë t'i menaxhojnë në një sistem kombëtar dixhital të dosjeve;
- numrin tim për identifikim të paraparë me ligj, si p.sh. numrin BSN dhe numrin V, ta përpunojnë vetëm në emrin tim dhe me porosinë time në kuadër të detyrimeve të mia ligjore që gjatë komunikimit me organizatat që kanë bazë ligjore për këtë, të përdorin atë numër për identifikim. Shoqata VluchtelingenWerk shprehimisht nuk e përpunon si përgjegjëse në kuptim të rregulloreve të privatësisë, por si përpunuese.

Të gjitha të dhënat e mia do të trajtohen në mënyrë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllime për të cilat jam informuar. Ato qëllime përbëjnë shoqërimin:

- gjatë rregullimit të strehimit;
- gjatë shoqërimit social;
- për qëllime shkollimi dhe pune;
- në procedura juridike *jashtë qendrave për azilkërkuës* (për shembull kur skadon leja juaj e qëndrimit).

Të dhënat e mia mund të përdoren po ashtu për zhvillim politikash brenda shoqatës VluchtelingenWerk. Për qëllime të reja do të furnizohem me informacione plotësuese nga shoqata VluchtelingenWerk.

Ky autorizim vlen për shoqatën kombëtare VluchtelingenWerk dhe për (shënoni me kryq ato që janë të zbatueshme):¹

- Shoqata VluchtelingenWerk Noord-Nederland [Holandë Veriore]
- Shoqata VluchtelingenWerk Oost-Nederland [Holandë Lindore]
- Shoqata VluchtelingenWerk Noordwest-Nederland [Holandë Veriperëndimore]
- Shoqata VluchtelingenWerk Zuidwest-Nederland [Holandë Jugperëndimore]
- Shoqata VluchtelingenWerk Zuid-Nederland [Holandë Jugore]
- Shoqata VluchtelingenWerk Midden-Nederland [Holandë e Mesme]
- Shoqata Nieuwkomers [persona të ardhur] dhe VluchtelingenWerk Brabant-Centraal [Brabant Qendror]

Vendi:

Data:

Mbiemri^{2*}:

Nënshkrimi*:

¹ Këtu shënoni me kryq vetëm një shoqatë. Në rast shpërnguljeje në rajonin e punës së një shoqate tjetër, kërkoni që të vihet nënshkrim i dytë me datë të re. Dy muaj pas nënshkrimit skadon automatikisht autorizimi si bazë për përpunimin e të dhënave personale për shoqatën e mëparshme me përjashtim nëse ju tregoni se autorizimi juaj vazhdon të vlejë. Mund të ndodhë megjithatë që shoqata e mëparshme të vazhdojë t'i përpunojë të dhënat tuaja mbi një bazë tjetër si p.sh. zbatimin e një dispozite ligjore, zbatimin e një marrëveshjeje në të cilën ju jeni palë apo një interesi të arsyetuar.

² *Për persona nën moshën 16-vjeçare nevojitet që përfaqësuesi i tyre ligjor të plotësojë emrin e vet e të nënshkruajë.

Informacion rreth përdorimit të të dhënave tuaja

Çka është Shoqata për Ndihmë të Refugjatëve (VluchtelingenWerk)?

Shoqata për Ndihmë të Refugjatëve (VluchtelingenWerk Nederland) është një organizatë e pavarur që angazhohet për të drejtat e refugjatëve dhe që i ndihmon të nisin një jetë të re në Holandë. Shoqata VluchtelingenWerk i shoqëron azilkërkuesit gjatë procedurës së tyre të azilit, gjatë integritit dhe për pyetje të tjera që parashtrihen nga azilkërkuesit. VluchtelingenWerk Nederland përbëhet nga një shoqatë kombëtare dhe nga shoqatat rajonale Noord-Nederland [Holandë Veriore], Oost-Nederland [Holandë Lindore], Noordwest-Nederland [Holandë Veriperëndimore], Zuidwest-Nederland [Holandë Jugperëndimore], Zuid-Nederland [Holandë Jugore], Midden-Nederland [Holandë e Mesme] dhe shoqata Nieuwkomers [persona të ardhur] dhe VluchtelingenWerk Brabant-Centraal [Brabant Qendror].

Ligji mbi mbrojtjen e të dhënave personale

Holanda ka legjislacion që mbron sferën tuaj private personale. Ligji mbi mbrojtjen e të dhënave personale (Wbp) rregullon mënyrën si shoqata VluchtelingenWerk duhet të silltet me të dhënat tuaja personale. Ky ligj përshkruan se kjo duhet të bëhet me kujdes dhe në mënyrë të sigurt. Çdo njeri të cilit i regjistrohen të dhënat ka të drejtë që ta mbikëqyrë përdorimin e drejtë të tyre. Prandaj ju keni të drejtë që në çdo çast të dhënat tuaja t'i shihni, përmirësoni, plotësoni, zhdukni, fshihni apo të lejoni që ato të transmetohen.

Të dhënat tuaja personale

Për t'ju ndihmuar sa më mirë, shoqatës VluchtelingenWerk i nevojiten të dhënat tuaja personale. Të tilla janë, për shembull, të dhënat e përgjithshme si emri dhe mbiemri juaj, adresa, nënshtetësia, datëlindja dhe të dhënat lidhur me procedurën tuaj të azilit dhe rrethanat tuaja personale. Të dhënat lidhur me rrethanat tuaja personale mund të përmbajnë të dhëna të posaçme personale. Të dhënat e tilla në Holandë konsiderohen si të dhëna posaçërisht të ndjeshme dhe ato duhet të trajtohen në mënyrë edhe më të kujdesshme. Ato mund të jenë të dhëna, për shembull, lidhur me racën tuaj, gjendjen tuaj shëndetësore, religjionin apo bindjen tuaj të përgjithshme apo bindjet tuaja politike. Ligji mbi mbrojtjen e të dhënave personale ndalon përdorimin e të dhënave të posaçme personale me përjashtim kur kjo për shembull është e nevojshme në bazë të ligjit apo nëse ju na keni dhënë shprehimisht leje për këtë. **Të dhënat tuaja të posaçme personale regjistrohen vetëm nëse kjo është e domosdoshme për procedurën tuaj të azilit.**

Autorizimi

Që të mund t'ju shoqërojmë, kërkojmë nga ju autorizim me shkrim për përdorimin e të dhënave tuaja dhe për ruajtjen e tyre në sistemin tonë të automatizuar të dosjeve. Nëse shpërnguleni në një lokalitet tjetër strehimi shoqata VluchtelingenWerk dosjen tuaj ia dërgon shoqatës VluchtelingenWerk në lokalitetin e ri për strehim, në mënyrë që atje të mund të vazhdohet shoqërimi juaj (në procedurë azili apo integrim).

Shoqata për Ndihmë të Refugjatëve (VluchtelingenWerk) i detyron të gjithë punonjësit e saj që të dhënat tuaja t'i trajtojnë në mënyrë konfidenciale.

Nëse nuk jeni i kënaqur me mënyrën se si shoqata VluchtelingenWerk silltet me të dhënat tuaja personale, për këtë mund të bëni ankesë. Rregullorja ku shpjegohet se si mund të bëni ankesë mund të gjendet e konsultohet te Shoqata për Ndihmë të Refugjatëve. Atë mund ta kërkonte kur të dëshironi.

A dëshironi më shumë informata?

Mënyra se si shoqata VluchtelingenWerk silltet ndaj të dhënave tuaja është përshkruar në një rregullore. Po qe se të gjitha këto ju duken të komplikuara dhe nëse në sajë të këtij njoftimi keni ndonjë pyetje, ju lutemi që lirisht të na kontaktoni. Detyra jonë është që sa më mirë t'ju ndihmojmë dhe informojmë.

Përshëndetje miqësore,

Shoqata Vluchtelingenwerk